

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Orët e gjata në punë, si ndikojnë në shëndetin sek*ual të meshkujve të rinj
ADRESA	https://versus.al/magazine/oret-e-gjata-ne-pune-si-ndikojne-ne-shendetin-sekual-te-meshkujve-te-ri-i46510
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:50:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 18:24:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a0ba5c5534ad8e8f3710d97681008d06b6deeeca5252706690100af347e84c38
TEKSTI	13e24e64e403871dc0f038780bdf8bfb39ac4f642dfc0cdf9356622f412b6b
PAMJA	b6094524afabed3d2a34ffe60f7b0f4fa32f5a5eb63cef3a0f2fc0fc5625f4e1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4e2df206420425a5eb24ef4d9c2acc13068d2dcd8aac358f2bdbd1105d3df0c4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4e2df206420425a5eb24ef4d9c2acc13068d2dcd8aac358f2bdbd1105d3df0c4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Reforma Territoriale, përplasje mes Ramës dhe aktore Eglë Ceno, banorët e Poliçanit bojkotojnë takimin](#)

13 Shtator 2026, 18:17

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
-

Created and monetized by
[MAGAZINë](#) / 13 Shtator 2026, 20:24

Orët e gjata në punë, si ndikojnë në shëndetin sek*ual të meshkujve të rinj



Shkruar nga Versus





Puna me orare shumë të zgjata mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin seksual të meshkujve të rinj, sipas një studimi të ri që lidh stresin në vendin e punës me rritjen e rrezikut për disfunktion erektil.

Studiuesit zbuluan se meshkujt që punonin rreth 13 orë në ditë kishin dukshëm më shumë gjasa të përjetonin probleme me funksionin seksual, krahasuar me ata që punonin rreth tetë orë në ditë. Më shumë se gjysma e meshkujve me javë pune shumë të gjata raportohet se përjetonin nivele të larta stresi dhe vështirësi me funksionin erektil.

Sipas rezultateve, ata kishin mbi dhjetë herë më shumë gjasa të zhvillonin këtë problem sesa meshkujt që bënin orare më të zakonshme pune dhe raportonin nivele më të ulëta stresi.

Stresi mund të ndikojë në testosteron

Shkencëtarët konstatuan gjithashtu se meshkujt më të stresuar kishin nivele të testosteronit rreth 40 për qind më të ulëta krahasuar me grupin që përjetonte më pak stres në punë.

Një nga shpjegimet e mundshme lidhet me kortizolin, hormonin që rritet gjatë periudhave të stresit.

Nivelet e larta dhe të vazhdueshme të kortizolit mund të ndikojnë negativisht në prodhimin e testosteronit, hormon që luan rol të rëndësishëm edhe në dëshirën dhe funksionin seksual.

Ekspertët kanë paralajmëruar prej kohësh se stresi kronik mund ta mbajë organizmin në një gjendje të vazhdueshme “lufto ose ik”, duke ndikuar në funksione të ndryshme të trupit, përfshirë sistemin riprodhues.

Në situata të tilla, organizmi përqendrohet më shumë në përballimin e stresit, ndërsa funksione të tjera, përfshirë ato seksuale, mund të ndikohen negativisht.

Studimi përfshiu mbi 800 meshkuj

Në hulumtim u përfshinë 826 meshkuj që punonin me orar të plotë, të moshës nga 22 deri në 40 vjeç.

Studiuesit analizuan pesë faktorë të lidhur me stresin në punë: numrin e orëve të punës, mundësinë për të marrë vendime, mbështetjen nga drejtuesit, marrëdhëniet me kolegët dhe presionin për avancim në karrierë.

Ekipi shkencor, i udhëhequr nga studiues të Shkollës së Mjekësisë së Universitetit Zhejiang në Kinë, vlerësoi gjithashtu aftësinë e pjesëmarrësve për të arritur ose mbajtur ereksionin dhe analizoi nivelet e hormoneve të tyre.

Disfunksioni erektil konsiderohet një problem relativisht i zakonshëm dhe mund të shfaqet në forma të ndryshme. Disa meshkuj mund ta kenë të vështirë të arrijnë ereksionin, ndërsa të tjerë mund ta arrijnë atë, por jo ta mbajnë për një kohë të mjaftueshme.

Mbi gjysma e meshkujve më të stresuar raportuan probleme

Rezultatet, të publikuara në “International Journal of Clinical Practice”, treguan se rreth 54 për qind e meshkujve në grupin me nivelin më të lartë të stresit kishin një formë të disfunksionit erektil.

Në grupin me stresin më të ulët, kjo përqindje ishte vetëm rreth tetë për qind.

Meshkujt më të stresuar punonin mesatarisht rreth 65 orë në javë, krahasuar me rreth 42 orë në grupin me ngarkesën më të ulët.

Nivelet e kortizolit të matur në mëngjes ishin rreth 74 për qind më të larta tek meshkujt më të stresuar, ndërsa niveli i testosteronit ishte rreth 40 për qind më i ulët.

Rreth një në pesë meshkuj të grupit me stres të lartë kishte disfunktion erektil të moderuar ose të rëndë, krahasuar me afërsisht një në 100 në grupin me stresin më të ulët.

Mbështetja nga shefi mund të ketë rol mbrojtës

Studiuesit identifikuan orët e gjata të punës si një nga faktorët kryesorë që lidhej me përkeqësimin e funksionit seksual.

Në të njëjtën kohë, mbështetja nga drejtuesit në vendin e punës dukej se kishte një efekt mbrojtës. Autorët e studimit arritën në përfundimin se ngarkesa fizike dhe psikologjike e punës mund të jetë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në funksionin erektil.

Ata vunë re gjithashtu se rritja e kortizolit zakonisht ndodhte dy deri në katër javë përpara se të fillonte ulja e testosteronit.

Ndryshimet në testosteron, nga ana tjetër, paraprinin përkeqësimin e funksionit erektil me rreth katër deri në gjashtë javë.

Sipas studiuesve, kjo mund të nënkuptojë se ekziston një periudhë gjatë së cilës ndërhyrja për uljen e stresit dhe përmirësimin e kushteve të punës mund të ndihmojë në parandalimin e përkeqësimit të shëndetit seksual.

Tags:

[shëndeti fizik dhe mendor](#)

Poll



MAGAZINË

[Me duartrokitje e trëndafila të bardhë, mijëra persona i japin lamtumirën e fundit këngëtarit grek Giorgos Mazonakis](#)

13 Shtator 2026, 20:50

^ekstrakti^



MAGAZINË

[“Xhaka më tha: të shkatërroj”, lojtari i Arsenalit tregon përplasjen me lojtarin shqiptar](#)

13 Shtator 2026, 19:49

^ekstrakti^



MAGAZINË

[I përmendën shokun e vdekur, Ronaldo shpërthen: Ata që e bënë të pezullohen përjetë, ky nuk është futboll](#)

13 Shtator 2026, 15:55

^ekstrakti^



MAGAZINË

"Zoti ju marroftë!", Mozzik reagon pasi mori pjesë në Marshin për Liri: Më kishin sharë nënën, gruan e vajzën

13 Shtator 2026, 15:29

^ekstrakti^



MAGAZINË

Alessio Aliaj zhvendoset në Tiranë, nis bashkëjetesën me Jonida Maliqin (FOTO)

13 Shtator 2026, 14:34

^ekstrakti^



MAGAZINË

Kreu i Anthropic ngre alarmin për inteligjencën artificiale: Duhet më shumë kontroll para se aftësitë e saj të dalin jashtë menaxhimit

13 Shtator 2026, 11:23

^ekstrakti^



MAGAZINË

"Shqipëri e Madhe"/ Cardi B bën shqiptonjën me duar dhe shpreh dashurinë për shqiptarët

13 Shtator 2026, 09:15

^ekstrakti^





MAGAZINË

[MOTI KËTË TË DIEL/ Kthjellime dhe vranësira në pjesën më të madhe të vendit, temperaturat arrijnë deri në 29°C](#)

13 Shtator 2026, 08:15

^ekstrakti^

[Të fundit](#)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.